



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI "A. XHUVANI" ELBASAN
SENATI

Tel. & Fax. 355 54 52593

VENDIM
Nr. 1 datë 11.01.2017

PER
MIRATIMIN E KRITEREVE SHITESË PER PRANIMIT NE PROGRAMET E
STUDIMIT NE UNIVERSITETIN E ELBASANIT "ALEKSANDER XHUVANI"

Bazuar në Ligjin Nr. 80 /2015 datë 22. 07. 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 pika 4/b, neni 4 pika 1, neni 23 pika 4, neni 25 pika 8, neni 38 pika 1/a dhe 3, neni 42 pika 7 neni 69 pika 3, neni 74 pika 2, neni 135, si dhe në propozimet e njëjësive kryesore të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan Senati akademik në mbledhjen e tij të datës 11.01.2017

V E N D O S I

I-Kriteret e pranimit për studentët e ciklit të parë të studimit, për vitin akademik 2017-2018, do të jenë si më poshtë:

- 1- Nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërorë, në masën 50% (mesatare e thjeshtë).
- 2- Nota mesatare e grup lëndëve (për të gjitha vitet ku shtrihen lëndët), të përzgjedhura nga fakultetet për çdo program studimi të ciklit të parë, në masën 50% (sipas tabelës bashkëngjitur).
- 3- Programi i studimit Edukim fizik dhe sporte konkursi i pranimit në masën 60%

II- Ky vendim shpallet dhe i përcillet Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof.Dr. Skender TOPI